

DEMOKRACIA DHE TË RINJTË



DEMOKRATËT E RINJË

FATJONA (15), ENIS (14), ARLINDA (14), ERMAL (14), ENDRITI (14), ALBINA (13), FABIONA (13)



Ne jemi demokratët e rinjë dhe sot kemi vendosur të flasim më tepër për demokracinë, zgjedhjet, lirinë, barazinë dhe të drejtat e njeriut

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Demokracia lindi në Greqi, në qytetin e Athinës më 507 p.e.s. Shteti i Kosovës ka një sistem demokratik parlamentar, sepse vendimet më të rëndësishme i merr Kuvendi, aty ku bëjnë pjesë deputetët. Deputetët janë shumë të rëndësishëm, sepse ata përfaqësojnë shtetin. Për një popull zgjedhjet janë

e shtetit. Në disa vende të botës si p.sh., në Shtetet e Amerikës, si shtete demokratike presidenciale, zgjedhja e Presidentit bëhet nga populli. Por, pasi që Kosova është shtet demokratik parlamentar, atëherë Presidentin e zgjedhin deputetët. Në Kosovë votohet mbi moshën 18 vjeçare. Secili qytetar duhet të votojë sepse vota jonë mund të ndryshojë gjithçka. Demokracia na siguron të drejta të barabarta për të gjithë. Disa nga të drejtat e njeriut janë: e drejta e të shprehurit lirshëm, e drejta e lojës, e shkollimit, e zgjedhjes së profesionit, etj. Ne, gjithashtu kemi përmendur që liria është element i demokracisë. Njerëzit duhet të kenë liri të mjaftueshme. Në këtë kohë duhet të jemi të pavarur, e më e rëndësishmja duhet të ndihemi të lirë në atë që bëjmë. Elemente të tjera të demokracisë janë: paqja, barazia, toleranca dhe solidariteti. Në një shtet demokratik njerëzit janë të lirë të vendosin, të zgjedhin, të shprehen dhe të jetojnë lirshëm pa presionin e dikujt. Kjo është shumë e rëndësishme për qytetarët dhe për zhvillimin e shtetit.



shumë me rëndësi, sepse në zgjedhje qytetarët zgjedhin udhëheqësit e tyre.


Në demokraci, secili nga ne bëjmë zgjedhje të ndryshme. Veshja jonë është zgjedhje, pasi që rrobat të cilat ne i veshim i zgjedhim për çdo ditë. Zgjedhjet në përditshmëri mund të jenë individuale, grupore, etj. Përmendëm se në Kosovë bëhet zgjedhja e deputetëve, ndërsa pastaj deputetët zgjedhin Presidentin



Nxënësit e klasës IX-1

POPULLI DHE PUSHTETI

ARMIR (14), ERMIRA (14), GRETA (15), EDONA (14), RIAD (14), LEARTA (14)



Ndarja e pushtetit në një shtet demokratik

Në demokraci bën pjesë edhe ndarja e pushtetit. Pushteti në Republikën e Kosovës ndahet në tri degë: Pushteti Legjislativ (Kuvendi), Pushteti Ekzekutiv (Qeveria) dhe Pushteti Gjyqësor (Gjykatat). Ndarja e pushtetit në këtë mënyrë bëhet që shteti të funksionojë sa më mirë dhe secili pushtet të kryej detyrat e tij në mënyrë të pavarur.

Në Pushtetin Legjislativ ku bën pjesë Kuvendi, nxirren dhe miratohen ligje të cilat kanë ndikim mjaft të madh tek ne si popull. Për shembull, një ligj i ri që merret për edukimin ka ndikim të madh tek ne sepse ne jemi përfituesit më të mëdhenj të këtij ligji. Në Kuvend, janë gjithsej 120 deputetë, të cilët zgjedhen nga votat e popullit.

Me zbatimin e ligjeve që bëhen në Kuvend merret Qeveria. Në Qeveri, bëjnë pjesë: Kryeministri, ministrat dhe zëvendës ministrat. Qeveria ka të drejtën e propozimit të projektligjeve, por këtë të drejtë e kanë edhe deputetët e Kuvendit, Presidenti i vendit, si dhe mbi 10.000 qytetarë. Projektligjet bëhen ligje vetëm nëse marrin shumicën e votave nga deputetët.

Për vendosjen e drejtësisë në vend merren gjykatat, të cilat bëjnë pjesë në Pushtetin Gjyqësor. Kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Pra, ndarja e pushtetit është shumë e rëndësishme për të gjithë shtetin, sepse nëse ndahen detyrat i gjithë vendi funksionon më mirë dhe nuk i bie shumë përg-

jegjësi vetëm një pushteti.

Një shembull të tillë e kemi edhe në klasën tonë. Kur ne i ndajmë detyrat dhe bashkëpunojmë me njëri-tjetrin kemi rezultate shumë më të mira.



Informacione për ndarjen e pushtetit



Gazetarët e rinjë



Bashkëpunimi në grup



E drejta e votës në Republikën e Kosovës




Ndërtesa e Qeverisë




Greta dhe Edona duke ilustruar ndarjen e pushtetit



E drejta për strehim



Barazia gjinore në demokraci



Gjykata Supreme



Erisa duke punuar për ballinën e gazetës

QYTETARË TË PAQES

FJOLLA (14), ARLINDI (15), ARBËRI (14), ERISA (14), ANTONETA (15), HANA (14)



Që të jemi të respektuar duhet të respektojmë!

Çdo njeri konsiderohet qytetar në vendin e vet pa marrë parasysh fenë, gjininë, racën, komunitetin, etj. Ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, edhe pse kemi të drejta dhe përgjegjësi, duhet të jemi më të kujdesshëm se si po veprojmë. Ne duhet të merremi me aktivitete të ndryshme, por më e rëndësishme është t'i ndihmojmë njerëzit me nevoja të veçanta. Gjithashtu, ne si qytetarë kemi të drejtë të respektohem nga të tjerët. Më të rëndësishme nga këto që i cekëm më lart janë paqja dhe liria.

Në shkollën tonë kemi ndërmarrë aktivitete, të tilla si pastrimi i oborrit të shkollës, kemi mbjellur pemë e lule, dhe si përfundim kemi dalur të kënaqur si ne nxënësit ashtu edhe arsimtarët tanë. Kjo përvojë doli në të mirën e të gjithëve.

Nga shumë të drejta dhe përgjegjësi të cilat i gëzojmë ne, qytetarët e Republikës së Kosovës, disa nga të drejtat tona janë: e drejta e emrit, e ushqimit, e drejta e lojës, e shkollimit, etj. Ne, po ashtu gëzojmë të drejtën e barazisë, të drejtën e të shprehurit lirshëm, dhe të drejtën e votës mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë do të jemi më të rritur dhe më të pjekur. Edhe pse kemi të drejtën e edukimit dhe të bashkëpunimit, është shumë e rëndësishme të jetojmë në liri dhe në paqe. Përveç të drejtave, ne kemi dhe përgjegjësi dhe ato janë: ta respektojmë njëri-tjetrin, t'i ndihmojmë njerëzit me nevoja të veçanta, t'i respektojmë shen-

jat e komunikacionit, të mbajmë të pastër ambientin, të jemi tolerant, t'i bëjmë detyrat, t'i parandalojmë krimet duke lajmëruar Policinë e Kosovës, dhe më e rëndësishmja të kemi solidaritet.

Ne si qytetarë të Republikës së Kosovës duam që të kemi respekt të madh ndaj njëri-tjetrit.



Qytetarë të Kosovës



Liria dhe paqja, pjesë e demokracisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë